



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT MBI MONITORIMIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË SHTETASVE NË PIKAT E KALIM KUFIRIT (PKK)

1. Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, gjatë periudhës nëntor – dhjetor 2011, ka ndërmarrë një raund vëzhgimesh në pikat kufitare të Muriqanit, Hanit të Hotit, Shëngjinit, Kakavijës, Kapshticës, Qafë-Botës, Tre Urat, Qafë Thanës, Tushemishtit, Goricës, Morinës, Portit të Vlorës, Durrësit dhe Sarandës, Aeroportit “Nënë Tereza”, Qendrës së Mbyllur të të Huajve në Vorë.

Qëllimi i misioneve të vëzhgimit ishte monitorimi më nga afër i respektimit të të drejtave të emigrantëve dhe shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga ana e policisë vendase dhe ajo e huaj, si edhe evidentimi i progresit të realizuar dhe problemet kryesore që janë hasur në këto pika të kalimit të kufirit.

Ajo çfarë rezulton është se pothuajse në të gjitha Pikat e Kalim Kufirit, është evidentuar një progres i dukshëm në krahasim me vëzhgimet e kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në vitet e mëparshme.

Ndër dokumentat strategjike që KShH i është referuar në kuadër të këtij monitorimi janë: Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013 dhe plani i saj i veprimit; Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 668, datë 29.09.2007; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1021, datë 14.10.2009 “Për miratimin e planit të veprimit të përditësuar të Strategjisë Kombëtare “Menaxhimi i Integruar i Kufirit”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.461, datë 9.6.2010 “Për miratimin e strategjisë "Për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer, 2010-2015" dhe planit të veprimit të saj; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.142, datë 23.2.2011 “Për miratimin e “Planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore” dhe të dokumentit plotësues “Plani i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat të trafikimit”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1140, datë 30.7.2008 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizmit”; Plani i veprimit i strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizmit, miratuar me V.K.M 1103, datë 14.11.2009 .

Lidhur me bazën ligjore për menaxhimin e kufijve, KShH ju referua disa ligjeve dhe akteve nënligjore si Ligji nr.9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”; Ligji nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”; Ligji nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”; Ligji nr.9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”; V.K.M nr.362, datë 1.04.2009 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; V.K.M nr.494, datë 1.8.2007 “ Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe kursantëve në shkollat e policisë dhe të shtetasve të ndaluar, deri në sqarimin e pozitës së tyre” .

2. Disa nga gjetjet e misioneve të monitorimit për të gjitha PKK



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

2.1 Infrastruktura

Gjatë monitorimeve u evidentua se janë bërë hapa pozitive të dukshëm përsa i përket infrastrukturës, në kuadër të financimit nga Bashkimi Europian, përmes Programit CARDS.

Në disa PKK si Shëngjin, Qafë-Botë, Tre Urat, Qafë Thanë, Tushemishtit, Goricë, Portit të Vlorës, Durrës dhe Sarandës, Aeroportit “Nënë Tereza” si dhe Qendrës së Mbyllur të të Huajve në Vorë, është bërë një investim i rendësishëm dhe në pjesën më të madhe të tyre janë arritur standartet e kërkuara.

Por pavarësisht nga kjo, në disa PKK u evidentuan probleme përsa i përket infrastrukturës, në të cilat, në disa prej tyre, kohët e fundit, nuk është bërë asnjë investim si në PKK Qafë Thanë, Kapshticë, Porti i Vlorës, Morinë – Kukës, etj.

U evidentua se nuk ka sistem ngrohjeje ose sistemi nuk funksion për shkak të defekteve të ndryshme, si në pikat e kalim kufirit të Qafë Thanës dhe Morinë Kukës. Megjithatë në disa PKK u konstatua se ishte bërë furnizimi me dru zjarri si në Korçë e Pogradec, ndërsa në të tjerat kryesisht ngrohja bëhej me energji elektrike.

Gjithashtu problem i konstatuar është mungesa e ambjenteve të domosdoshme për kryerjen e nevojave personale nga shtetasit që kalojnë PKKK (një tualet publik), gjë e cila krijon shqetësim për ata persona dhe për mjedisin përreth. Edhe pse kjo çështje është ngritur dhe më parë nga KShH ende nuk është bërë asgjë për gjetjen e një zgjidhje të përshtatshme për këtë shqetësim të drejtë të qytetarëve.

Ajo që u vu re në pikën e kalim kufirit të Tre Urave në Përmet, ishte se infrastruktura e rrugës për të shkuar në këtë PKK është shumë e keqe dhe mungon sinjalistika për orientimin e shtetasve. Punonjësit e kësaj PKK jetonin kryesisht në Përmet dhe kishin vështirësi shumë të mëdha për të shkuar në vendin e punës.

2.2 Ambjentet pritëse dhe intervistuese të personave të deportuar dhe INAD

Për pritjen dhe intervistimin e personave të deportuar apo INAD, në disa PKK u vunë re ambjente të posaçme për akomodimin e tyre dhe gjendja e kushteve që ofrojnë është e kënaqshme. U konstatua se këto ambjente ishin në gjendje të mirë, të pastra dhe të rregullta si në: PKK të Portit të Durrësit, Shëngjinit, Kakavijës, Kapshticës, Qafë-Botës, Portit të Vlorës dhe Sarandës, Aeroportit “Nënë Tereza” dhe Qendra e Mbyllur e të Huajve në Vorë.

Pavarësisht sa më sipër në disa PKK, ambjentet e përshtatshme për intervistimin dhe qëndrimin e personave të deportuar dhe INAD mungonin, si në PKK: Qafë Thanë, Goricë, Morinë, Hani i Hotit, Porti i Vlorës, etj. Intervistimi në disa PKK bëhej në zyrat e operatorëve dhe më pas çoheshin në dhomën e posaçme ose në ambjentet e posaçme (*qëndrave Gos*), ndërkohë që në disa nga këto PKK funksiononte vetëm një banjë e njëjtë si për femrat ashtu dhe për meshkujt.

Ambjentet e “Qëndrave Gos” ishin në disa raste të papërshtatshme për qëndrim më shumë se disa orë, sidomos dhomat për meshkujt shpeshherë nuk kishin pajisje të nevojshme për qëndrim, përveçse karrige, konkretisht si në PKK të Goricës, Kapshticës, etj.

U evidentua mungesë e ambjenteve të veçantë për femrat dhe fëmijët në PKK të Tre Urave, Morinë Kukës, Tre Urat dhe Murriqanit, që në disa raste kjo mungesë është justifikuar me



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

fluksin e ulët të këtyre kategorive. Por dhe në disa PKK ku këto dhoma ekzistojnë ato paraqiten me kushte minimale për qëndrimin e kësaj kategorie, si në PKK e Qafë Thanës, etj.

Gjithashtu, gjatë monitorimeve është vërejtur mungesë e ambjenteve të zyrave për përgjegjësit e turnit si në PKK të Morinës Kukës.

2.3 Krijimi i kushteve për trajtimin sa më mirë të shtetasve

Një ndër kriteret për krijimin e kushteve sa më të mira për trajtimin e shtetasve është dhe shpejtësia e veprimeve dhe moskrijimi i rradhëve të gjata në pikat e kalim kufirit. Nga monitorimi u vu re se numri i sporteleve, të vënë në dispozicion në situatë normale, në Pikat e Kalim Kufiri që u monitoruan, ishte i mjaftueshëm për përballimin e fluksit të hyrje daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë. Vlen të theksohet se numri i sporteleve shtohet në kohë fluksi deri në 2 – 3 fishimin e tyre, në funksion të fluksit të hyrjeve dhe daljeve, pavarësisht se në periudha festash ose pushimesh, disa pika kufitare me Greqinë mbeten problematike në këtë këndvështrim. Gjithashtu zbatohet sistematikisht orari i lëvizjes në PKK dhe destinacioni i tyre.

Gjatë monitorimeve u vërejt se mbetet problematike sigurimi i ushqimit të personave të deportuar dhe INAD e cila zgjidhet në të shumtën e rasteve nëpërmjet blerjeve me të ardhurat e punonjësve dhe më pas bëhet rimbursimi nga Drejtoria Rajonale e Kufirit¹. Për këtë arsye mendojmë se është më efektive përfshirja dhe shtimi në buxhetin e Departamentit të Policisë Kufitare dhe Migracionit të zërit përkatës për të gjitha PKK, për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me plotësimin e nevojave ushqimore të personave të deportuar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Mungesa e materialeve informuese mbi të drejtat e njeriut, që lidhen me trajtimin e tyre nga policitë, si ato në gjuhën shqipe dhe të huaj ishte një problem i evidentuar përgjithësisht. Ekzistenca e disa materialeve sensibilizuese mbi lirinë e lëvizjes, sipas mendimit të vëzhguesve të KSHH-së, nuk e ezauron këtë nevojë.

2.4 Kompletimi me personelin e nevojshëm të PKK

Nga informacioni i marrë nga personeli i pikave të kalim kufirit, rezultoi se pothuajse të gjitha PKK ishin të kompletuara me personelin e nevojshëm, me përjashtim të Stacionit të Policisë Kufitare Tre Urat në Përmet, ku sipas drejtuesit të këtij stacioni kërkohej shtesë organike me 10 persona. Në stacionet e tjera, personeli ishte i plotë dhe i mjaftueshëm për të përballuar detyrat e ngarkuara.

Në pjesën më të madhe të pikave kufitare të vëzhguara, personeli i tyre ishte plotësuar me personel femër, gjë e cila përbën një ndryshim pozitiv, në raport me të kaluarën, si dhe plotëson standartet e kërkuara në nenin 8/1 dhe 2, ligjin nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, pika 1 dhe 2 e nenit 8 dhe VKM 804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Shtetit”, në të cilën përcaktohet se minimalisht 50% e kandidatëve që pranohen në polici të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar.

¹ Referuar VKM nr.494, datë 1.8.2007 “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe kursantëve në shkollat e policisë dhe të shtetasve të ndaluar, deri në sqarimin e pozitës së tyre”



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Është për tu përgëzuar që në përbërjen e Aeroportit “Nënë Tereza” janë respektivisht 50% e stafit femër dhe në Portin e Durrësit 25% e stafit ishte femër. Megjithatë është vënë re se në disa pika kufitare, mungesa e personelit femër krijonte vështirësi, sidomos për intervistimin e të deporturave femra ose kontrollet fizike të udhëtarëve femra. Kështu në PKK Morinë Kukës, Tre Urat në Përmet, Shëngjinit në Lezhë, Tushemishtit në Pogradec, Kakavija në Gjirokastër, Qafë Thanë, Hani i Hotit, Porti i Vlorës dhe i Sarandës, numri i punonjësve femra ishte i pakët. Më shqetësuese gjendja paraqitej në PKK Goricë në Korçë dhe Murriqan në Shkodër ku nuk kishte asnjë punonjëse policie femër.

Një shqetësim me rëndësi, i nënvizuar nga punonjësit e pikave kufitare të vëzhguara, ishte mungesa e psikologut në organikën e Pikave të Kalimit Kufitar. Shtimi në organikë me psikolog është mëse i domosdoshëm për vetë kushtet dhe problematikën që paraqitet në rastet e personave të intervistuar, sidomos në rastet e femrave të trafikuar dhe të miturve.

2.5 Ngritja e kapaciteteve të stafit të Pikave të Kalim Kufirit

Ndryshime pozitive viheshin re dhe në përmirësimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit. Nga informacionet e marra rezultoi se ishin realizuar disa trajnime për punonjësit e policisë të pikave kufitare. Pavarësisht nga kjo, KShH ka mendimin se ende ka nevojë për përmirësime të mëtejshme të kapaciteteve profesionale dhe për njohjen më të mirë të legjislacionit nga ana e punonjësve të pikave kufitare, sidomos legjislacionit mbi të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe atyre që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre në rastet e keqtrajtimit nga policia apo liria e lëvizjes.

2.6 Funkionimi i Sistemit të Menaxhimit të Teknologjisë të Informacionit (TIMS)

Në përgjithësi, në të gjitha pikat kufitare të vëzhguara nga KShH, sistemi TIMS funksiononte normalisht dhe nuk paraqiste probleme. Punonjësit e policisë kufitare dhe migracionit ishin trajnuar dhe kualifikuar për shfrytëzimin e këtij sistemi. Pozitive, në një pjesë të mirë të PKK, ishte zgjidhja e problemit kur mungonte energjia elektrike, sepse menjëherë vihej në punë gjeneratori. Në rastet e problemeve në sistemin TIMS, të dhënat hidheshin fillimisht manualisht në një rregjistër, dhe më pas në sistem kur ai rregullohej. Problematike paraqitet pika e kalim kufirit të Hanit të Hotit, pasi ndezja e gjeneratorëve varet nga një pikë karburanti, aty pranë, me të cilën kjo pikë ka bërë marrëveshje për furnizim me energji në rastin e ndërprerjes nga rrjeti.

2.7 Marrëdhëniet me policinë homologe të shteteve fqinje

Bazuar në informacionet zyrtare, marrëdhëniet e bashkëpunimit të policisë kufitare dhe migracionit shqiptare me ato të vendeve fqinje ishin shumë të mira. Ndërmjet tyre kishte shkëmbime informacioni dhe takime periodike. Në këto takime bëheshin analiza të përbashkëta të gjendjes dhe prioriteteve, si dhe koordinim të punëve për mbarëvajtjen e ruajtjes së kufirit. Është për t'u evidentuar nënshkrimi dhe funksionimi i marrëveshjeve të patrullimeve të përbashkëta të kufirit.

Gjithashtu funksionon normalisht pika e përbashkët e kalim kufirit shqiptaro-malazeze e Muriqanit në Shkodër dhe është në proces hapja e të njëjtë pike në kufirin shqiptaro-kosovar në Morinë të Kukësit.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ajo çfarë është evidentuar nga monitorimi është se, në Pikat e Kalim Kufirit të vëzhguara, rastet e denoncuar mediatisht për keqtrajtim fizik të qytetarëve shqiptar nga policia e vendeve fqinjë, pothuajse nuk janë evidentuar fare.

Nga monitorimet e kryera në pikat e kalim kufirit me shtetin grek u informuam se janë refuzuar hyrjet nga pikat e kalimit grek të shtetasve shqiptarë të cilët janë me origjinë nga krahina e Çamërisë. Këto refuzime nga policia greke janë justifikuar me arsye të tjera.

Shqetësim u konstatua edhe në rastet e refuzimit të hyrjeve të shtetasve shqiptarë për arsye të problematikës ligjore që kanë patur më përpara në shtetet fqinjë (Itali, Greqi). Nga intervistat e bëra me këta persona u ngrit pretendimi se nuk kishin dijeni për masën e marrë ndaj tyre nga autoritetet e atyre shteteve dhe ky refuzim përveç të tjerave i dëmtonte ata ekonomikisht me shpenzimet e kryera të udhëtimit. Gjithashtu ata ngritën pretendimin se këto masa mund të ankimohen vetëm në autoritetet administrative dhe gjyqësore të atyre shteteve, ndërkohë që ata e kanë të pamundur të bëjnë këtë ankimim sepse nuk u lejohet hyrja në shtetet ku bëhet ankimi. Për këtë arsye, nevojitet një rol më aktiv i përfaqësive tona diplomatike dhe konsullore në këto vende, me qëllim sigurimin e lehtësirave të nevojshme në mbrojtjen e interesave të shtetasve shqiptarë të refuzuar.

Rekomandime

Nisur nga konstatimet e mësipërme Komiteti Shqiptar i Helsinkit sugjeron:

- I sugjerojmë Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të marrin masa konkrete për ndërhyrjen pranë autoriteteve kompetente shtetërore të shteteve fqinj për zgjidhjen e çështjes së refuzimit të hyrjes dhe trajtimit të shtetasve shqiptarë me vendlindje krahinën e Çamërisë.
- Në ato Pika Kalimi Kufiri ku mungojnë kushtet e akomodimit për personat e deportuar, të përmirësohen sa më parë, veçanërisht përmirësimi i ambienteve të pritjes dhe sistemit të shtetasve që kane probleme, si dhe të kryhet mobilimi i tyre.
- Të merren masa, jo vetëm për planifikimin e fondeve financiare të nevojshme për trajtimin ushqimor të personave deportivë, por të sigurohet edhe furnizimi me ushqim i tyre.
- KShH i rekomandon Departamentin e Policisë Kufitare dhe të Migracionit për plotësimin e organikës të punonjësve të Policisë Kufitare dhe Migracionit me personel femër pasi prania e tyre është shumë e nevojshme për intervistimin e të deportuarave femra dhe të mitur. Kjo në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara dhe angazhimet e marra nga Policia e Shtetit për vendosjen e barazisë gjinore.
- Gjithashtu KShH i rekomandon Departamentit të Policisë Kufitare dhe të Migracionit të marrë masat konkrete për të siguruar prezencën e piskologut në momentin e intervistimit të femrave të trafikuar dhe të miturve.
- I rekomandohet entit përgjegjës shtetëror marrja e masave për vendosjen e tabelave orientuese rrugore gjë e cila do t'i vijë shumë në ndihmë qytetarëve që udhëtojnë jashtë shtetit dhe anasjelltas.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- Vendosja në vende të dukshme në të gjitha PKK, të materialeve mbi të drejtat e njeriut që lidhen me trajtimin e tyre nga policitë, si ato shqiptare ashtu dhe të huaj.
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit për të disatën herë me rradhë kërkon nga ana e autoriteteve përkatëse shtetërore marrjen e masave konkrete dhe të menjëhershme për krijimin e ambjenteve të domosdoshme dhe sigurimin e kushteve higjeno-sanitare për nevojat personale të qytetarëve (tualetëve publike).
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit i sugjeron Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, të shikojë mundësinë e krijimit të marrdhenieve të bashkëpunimit midis policive fqinjë që janë antare të Shengenit (greke dhe italiane), për të dhënë paraprakisht listën e shtetasve të cilëve u ndalohet hyrja në shtetin fqinjë.
- Gjithashtu KShH i sugjeron Ministrisë së Punëve të Jashtme, të krijojë hapësira e mundësi për shtetasit shqiptarë, që pretendojnë se janë deportuar apo prapësuar në mënyrë të paligjëshme nga policitë e vendeve fqinjë, të mbrohen para organeve kompetente të këtij shteti për të kundërshtuar këtë akt.